

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zelensky: Të gatshëm të ndalojmë sulmet në qytetet ku po diskutohet arritja e paqes
ADRESA	https://indeksonline.net/zelensky-te-gatshem-te-ndalojme-sulmet-ne-qytetet-ku-po-diskutohet-arritja-e-paqes/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 23:09:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 16:33:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bc92d92fc9e80852826854306cd3af97b8b0e409901badcf62fc08a9c93460c2
TEKSTI	58e06ed31604e083a1aeedbc1c0e2a94e93ae279686f490d85c1931c69e34d87
PAMJA	e04704b5c56146adc2188ea603c70ef2c798f907118129eec0c454302a001860

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e6bde31517a2d28188bcc11313bb6dc5f49b10b4beac3df047d2440d7f78a0fc
E MËPARSHMJA	c12ec0a6d4ff2fa870b74af027511823e64555adf511e7e4625a37609c2d58b9
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3f5b5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e6bde31517a2d28188bcc11313bb6dc5f49b10b4beac3df047d2440d7f78a0fc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)








SHPËRNDAJE

18:33 / E Shtunë, 05 Shtator 2026 / MSH1

Zelensky: Të gatshëm të ndalojmë sulmet në qytetet ku po diskutohet arritja e paqes



Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky deklaroi të shtunën se vendi i tij është i gatshëm të ndalojë sulmet ndaj qyteteve të përfshira në përpjekjet e ndërmjetësua nga SHBA për arritjen e një marrëveshjeje për përfundimin e luftës Rusi-Ukrainë.

Në një deklaratë në rrjetin social amerikan X, Zelensky tha se gjatë ditës ka biseduar me të dërguarit amerikanë që udhëtuan në Moskë për bisedime dhe se ata tashmë kanë nisur punën në Rusi.

“Që nga momenti i kësaj bisede, ne jemi të gatshëm të respektojmë një armëpushim në sulmet ajrore ndaj qyteteve të përfshira në procesin e negociatave.

“Që nga tani deri në fund të së shtunës, si dhe të dielën dhe të hënën, Ukraina është e gatshme të përmbahet nga sulmet ndaj Moskës dhe presim që rusët të bëjnë të njëjtën gjë lidhur me Kievin”, shtoi Zelensky.

Deklarata e presidentit ukrainas erdhi pasi Kremlini njoftoi se presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar një ndalim treditësh të sulmeve ndaj Kievit, duke filluar nga mesnata sipas kohës lokale.

Më herët të shtunën, i dërguari i posaçëm i SHBA-së, Steve Witkoff, dhe dhëndri i presidentit Donald Trump, Jared Kushner, mbërritën në Moskë për bisedime që synojnë gjetjen e një marrëveshjeje për përfundimin e konfliktit, i cili ka zgjatur më shumë se katër vjet.

Të dërguarit amerikanë pritet të vizitojnë të dielën kryeqytetin ukrainas, Kievin, për herë të parë pas udhëtimit të tyre në Moskë.

Trump tha të premten se Kushner dhe Witkoff do të udhëtojnë në Moskë jo me ide të reja, por me një propozim që synon t’i japë fund luftës.

“Ata po marrin me vete një propozim për t’i dhënë fund luftës”, tha Trump, duke iu referuar dy negociatorëve.


Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)






- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)



- [“I ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i duhur gjobitet 2 herë, brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'c përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksidenti i rëndë në autostradën “Ibrahim Rugova”, të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Lajme

- [00:05 / E Hënë, 07 Shtator](#)
[26-vjeçari plagoset me thikë në Tiranë](#)
- [23:25 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Një person me probleme shëndetësore u shkakton lëndime dy familjarëve, arrestohet nga policia](#)
- [23:13 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Tragjike në Rahovec: I mituri gjendet i plagosur me armë zjarri, mjekët konstatojnë vdekjen](#)
- [22:56 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Dyshohet se sulmuan kapitenin Besart Ahmeti, dy të dyshuarit janë djemtë e këtij polici](#)
- [22:28 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Gjendet pa shenja jete një person në Mitrovicë](#)
- [22:10 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: 20 vatra zjarri në vend, 11 mbeten aktive](#)

TEL Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666 **EMAIL** info@indeksonline.net | marketing@indeksonline.net [Indeksonline.net](https://indeksonline.net)



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.